TOP CHANNEL

Top Channel

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

2015

BAKER TILLY
ALBANIA
Rr.Themistokli Germenji, Nr.2
Pall.Ambasador 1, 3-rd floor
Tirana
Albania
T: +355(0)42232726
www.bakertillyalbania.com

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëngjitur të Top Channel sha. që përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të fitim - humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2015, pasqyrën e konsoliduar të flukseve te parase dhe pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabile dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brëndshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësira; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin proçedura për të marrë evidencë auditimi për vlerat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë dhe vlerësimin e riskut të egzistencës së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësira. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, audituesi konsideron kontrollin e brëndshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brëndshëm të shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të Top Channel sha. paraqesin në mënyrë të sinqertë në të gjitha aspektet materiale gjëndjen financiare të shoqërisë më 31 Dhjetor 2015, rezultatin financiar dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Baker Tilly Albania shpk.

Elton Haxhi
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Tiranë
29 Prill 2016

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	I,II
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIM-HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	1
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARASË	3
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5-33

PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT-HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
(Vlerat në Lek)

	Shënime	Per vitin e mbyllur me 31.12.2015	Per vitin e mbyllur me 31.12.2014 (*Riparaqitur)
Të ardhura nga aktivlteti i shfrytëzimit	6	1,646,341,166	1,619,866,280
Të ardhura të tjera	7	973,313	-
Total të ardhura		**1,647,314,479**	**1,619,866,280**
Materiale dhe shërbime te konsumueshme	8	(527,395,568)	(554,790,191)
Shpenzime personeli	9	(741,205,545)	(722,554,672)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10	(300,539,912)	(196,171,152)
Shpenzime të tjera	11	(21,922,859)	(53,958,295)
Totali i shpenzimeve		**(1,591,063,884)**	**(1,527,474,310)**
Shpenzime interesi dhe të ngjashme	12	(67,560,415)	(81,300,642)
Shpenzime financiare neto	13	20,337,986	4,074,959
Fitim para tatimit		**9,028,166**	**15,166,287**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	14	(8,275,072)	(11,938,452)
Fitimi i vitit		**753,094**	**3,227,835**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse per vitin :		**546,264**	-
Diferenca (+/-) nga përkthimi i monedhes në veprimtarite e huaja		546,264	
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse qe i përket aksionareve te kompanisë mëmë		**1,299,358**	**3,227,835**

*Referoju shenimit 4.15

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR

Në 31 Dhjetor 2015
(Vlerat në Lek)

	Shënime	31.12.2015	31.12.2014
AKTIVET			
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale dhe jomateriale	15	2,321,160,961	2,087,148,653
Llogari te arkëtueshme të tjera	16	4,439,936	4,557,319
Aktive afatgjata financiare	17	5,079,360	-
		2,330,680,257	**2,091,705,972**
Aktivet afatshkurtra			
Inventar	18	2,651,455	675,438
Llogari të arkëtueshme tregëtare	19	579,721,500	531,910,283
Llogari të arkëtueshme të tjera	20	24,378,836	14,289,153
Parapagime për furnizime	21	643,710	18,456,547
Shpenzime të periudhave të ardhme	22	107,792,233	101,401,562
Mjetet monetare	23	9,921,903	13,682,872
		725,109,637	**680,415,855**
Totali i aktiveve		**3,055,789,894**	**2,772,121,827**
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali			
Kapitali aksionar	24	525,400,000	525,400,000
Rezerva të tjera		208,409,702	205,343,259
Rezerva ligjore		10,484,721	10,323,329
Fitime të mbartura		124,399,269	124,399,269
Fitimi i ushtrimit		1,299,358	3,227,835
		869,993,050	**868,693,692**
DETYRIMET			
Hua afatgjata	25	636,550,907	774,216,231
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera	26	7,483,188	7,829,191
Detyrime të tjera afatgjata		40,637,846	19,698,838
		684,671,941	**801,744,260**
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	27	406,887,930	349,158,333
Llogari të pagueshme tregëtare	28	849,657,552	580,867,700
Parapagimet e arkëtueshme	29	205,633,728	139,802,295
Të ardhura të shtyra			4,166,667
Llogari të pagueshme të tjera	30	38,945,693	27,688,880
		1,501,124,903	**1,101,683,876**
Totali i detyrimeve		**2,185,796,844**	**1,903,428,135**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**3,055,789,894**	**2,772,121,827**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARASË

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
(Vlerat në Lek)

	Për vitin e mbyllur	*Për vitin e mbyllur*
	31.12.2015	**31.12.2014**
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	9,028,166	15,166,287
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Amortizim	194,310,015	124,794,013
Rimarrje amortizimi nga grantet	(346,003)	-
Provizione	20,000,000	-
Kuota pjese për tu shperndare/ Te ardhura nga grante	86,827,453	62,008,526
Nxjerrje jashte perdorimit e AAM-ve neto	(253,676)	2,961,275
Shpenzime interesi	67,560,415	81,303,461
Diferenca konvertimi nga perkthimi	587,392	
Interesa te perllogaritura		-
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues		
Ndryshimi ne inventar	(1,976,017)	4,025,118
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera	(81,083,697)	46,425,927
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera	342,564,072	182,244,965
Ndryshimi ne parapagime e shpenzime te shtyra	(75,405,287)	(59,562,196)
Ndryshimi ne te ardhura te shtyra	(4,166,667)	25,749,156
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative	**557,646,166**	**485,116,533**
Interesa te paguara	(67,379,520)	(81,057,069)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjate vitit	(1,841,761)	(13,997,098)
	(69,221,281)	**(95,054,167)**
Aktivitetet investuese		
Blerje te aktiveve afatgjata material	(430,887,847)	(348,929,056)
Shitje e aktiveve afatgjata material	2,778,071	-
Investime ne filiale	(5,079,360)	-
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues	**(433,189,136)**	**(348,929,056)**
Aktivitetet financuese		
(Ripagim) nga kredite	(1,902,042,796)	(1,592,476,844)
Te hyrat neto nga kredite	1,843,046,078	1,549,424,503
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues	**(58,996,718)**	**(43,052,341)**
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	**(3,760,969)**	**(1,919,032)**
Mjetet monetare ne fillim te periudhës	13,682,872	15,601,904
Mjetet monetare ne fund te periudhës	**9,921,903**	**13,682,872**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
(Vlerat në Lek)

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	Fitim te pashpërndara	Fitimi/Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013	**525,400,000**	**89,270,004**	**4,214,210**	**124,399,269**	**122,182,374**	**865,465,857**
Te ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin						-
Fitimi/Humbja e vitit					3,227,835	**3,227,835**
Transferuar në Fitim/(Humbje) të mbartur		116,073,255	6,109,119		(122,182,374)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	**525,400,000**	**205,343,259**	**10,323,329**	**124,399,269**	**3,227,835**	**868,693,692**
Te ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin						-
Fitimi i vitit					753,094	753,094
Transferuar ne Fitim/(Humbje) të mbartur		3,066,443	161,392		(3,227,835)	-
Të ardhura te tjera gjithpërfshirëse					546,264	546,264
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	**525,400,000**	**208,409,702**	**10,484,721**	**124,399,269**	**1,299,358**	**869,993,050**

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 5 deri ne 33, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër te saj nga:

Vjollca Hoxha

Vjollca Hoxha
Drejtoreshë e Përgjithshme

Mazars shpk

Mazars shpk
Rr. Emin Duraku, Pall "Besalem", No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 60 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Shenime mbi pasqyrat financiare

1. Informacion i pergjithshem

Top Channel sh.a. ("Shoqëria") eshte nje kompani aksionere, e cila është krijuar ne vitin 2001 me vendim gjykate Nr. 25561 datë 29.03.2001. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatese te ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtaret dhe Shoqërite tregtare" dhe nga statuti i saj.
Adresa e selisë së shoqerisë është Rruga 17 Nentori, Godina nr.2 Kashar

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie eshte ne fushen e veprimtarisë televizive kombëtare që përfshin prodhimin, transmetimin e programeve te informacionit të cdo lloji me anë te zërit dhe figurës, sinjaleve te koduara, dhe shkrimit te destinuara per publikun.

Veprimtaria radiotelevizive zhvillohet në përputhje me ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, me dispozitat e ligjit Nr. 8410, datë 30.9.1998 PËR RADION DHE TELEVIZIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Pasqyrat financiare jane te konsoliduara duke perfshire Pasqyrat financiare Top Channel Tirane , dega Top Channel ne Kosove dhe dega e Top Chanel ne Maqedoni.

Perfaqësues Ligjor i shoqerisë Top Channel sh.a është znj.Vjollca Hoxha.
Kompania ka 600 punonjës deri me 31 Dhjetor 2015 per zyrën e Tiranës. (2014: 596)

2. Aplikimi i standarteve nderkombetare te raportimit financiar te reja dhe te rishikuara

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme aplikohen për herë të parë për periudhat e raportimit financiar që fillojnë me ose pas datës 1 janar 2015.

Përmirësimet vjetore ndaj IFRS-ve për cilët vjetore 2010-2012 dhe 2011-2013:

- SNRF 2 *"Pagesat bazuar ne aksione"*– qartëson përcaktimin e "Konditës së kushtëzimit" dhe bën dallimin ndërmjet 'kushtit të performancës' dhe 'kushtit të shërbimit'.
- SNRF 3 "Kombinimet e Bizneseve - Kontabiliteti për detyrimet e mundshme në një kombinim biznesi"– qartëson se një detyrim për të paguar një shumë të kushtëzuar klasifikohet si detyrim financiar ose si kapital bazuar në parimet e SNK 32 (Instrumentet Financiarë: Paraqitja) dhe se e gjithë shuma e kushtëzuar (detyrim financiar ose jo) matet me vlerën e drejtë në cdo datë raportimi.
- SNRF 3 – qartëson se SNRF 3 nuk gjen zbatim në kontabilizimin e lidhjeve të marrëveshjeve të përbashkëta.
- SNRF 8 "Segmentet e shfrytëzimit"– kërkon shënime shpjeguese sa i përket gjykimeve të Menaxhimit në lidhje me konsolidimin e segmenteve të aktivitetit te kompanisë dhe qartëson se për një rakordim të segmenteve te aktiveve mund të jepen shpjegime vetëm nëse segmentet e aktiveve bëhen te njohura.
- SNRF 13 "Vlera e drejtë e matjes" konfirmon se llogaritë e arkëtueshme apo të pagueshme afatshkurtra mund të vazhdojnë te maten me vlerën e faturuar nëse impakti nga skontimi është jomaterial.
- SNRF 13 - sqaron se përjashtimet në SNRF 13 (matja e vlerës së drejtë të një grupi aktivesh dhe detyrimeve financiare mbi bazë neto) zbatohet për të gjitha kontratat brenda objektit të SNK 39 ose SNRF 9

2. Aplikimi i standarteve nderkombetare te raportimit financiar te reja dhe te rishikuara (vazhdim)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

SNK 16 – "Aktivet Afatgjata Materiale" dhe SNK 38 "Aktivet jo-materiale" – sqarojnë se si trajtohen vlera e mbetur dhe amortizimi i akumuluar në rastin kur një entitet kryen rivlerësim të aktiveve.

- IAS 24 – sqaron se kur një entitet merr shërbime menaxhimi nga personeli i një palë të tretë (një entitet menaxhimi), tarifat e paguara për ato shërbime duhet të pasqyrohen në shënimet shpjeguese nga entiteti raportues, por jo pagesa që entiteti i menaxhimit i bën punonjësve apo drejtorëve të tij.).
- IAS 40 – sqaron se SNK 40 dhe SNRF 3 nuk janë reciprokisht ekskluzive në bërjen e dallimit midis pronës së investimit dhe pronës që shfrytëzohet nga pronari dhe përcaktimin nëse blerja e një prone investimi mund të cilësohet si një kombinim biznesi.

Amendimi ndaj SNK 19 – "Përfitimet e punonjësve" (publikuar në nëntor 2013 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 korrik 2014.) Ndryshimet sqarojnë kontabilizimin për përfitimet e punonjësve të cilat kërkojnë që punonjësit apo ndonjë palë e tretë të kontribuojnë drejt kostos së përfitimeve. Këto ndryshime lejojnë kontributet që lidhen me shërbimet, por që nuk ndryshojnë me jetëgjatësinë e shërbimit të punonjësit, (p.sh. si një % fikse ndaj pagës), të zbriten nga kosto e përfitimeve gjatë periudhës që shërbimi është ofruar. Për këtë, shumë entitete mund të vazhdojnë (por nuk janë të detyruara) të kontabilizojnë kontributet e punonjësve duke përdorur politikat e tyre aktuale të kontabilizimit.

2.2 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Deri më datë 30 prill 2015, standardet dhe interpretimet si më poshtë të publikuara nuk kanë qenë të detyrueshme për periudha raportuese që mbarojnë më 31 dhjetor 2015:

- Amendimi ndaj SNRF 9 – "Instrumentat Financiare" (publikuar në korrik 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht për periudha financiare qe fillojnë me 1 shkurt 2015.)
- Amendimi ndaj SNRF 10 dhe SNK 28 – "Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe partnerit në nje sipërmarrje të përbashkët" (publikuar në shtator 2014, dhe me datë efektivë të shtyrë deri në një deklarim të dytë).
- Amendimet ndaj SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 – "Investimet në pjesëmarrje: Aplikimi i përjashtimeve të konsolidimit" (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2016.
- Amendimi ndaj SNRF 11 – "Kontabilizimi i blerjeve të Pjesëmarrjeve në Marrëveshje të Përbashkëta" (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më janar 2016.
- SNRF 14 – "Llogaritë e Shtyra për Arsye Rregullatore" (publikuar në janar 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më janar 2016.)
- SNRF 15 – "Të ardhurat nga Kontratat me Klientët" (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht)
- Amendimi ndaj SNK 1 – "Iniciativë mbi Dhënie Informacionesh Shpjeguese" (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016.)
- Amendimi ndaj SNK 16 dhe SNK 38 – "Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Amortizimit dhe Zhvlerësimit" (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas datës 1 janar 2016.)
- Amendimet ndaj SNK 16 dhe SNK 41 – "Bujqësia: Bimët Bartëse" (publikuar në qershor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas dates 1 janar 2016.)
- Amendimi ndaj SNK 27 – "Metoda e Kapitalit në pasqyrat financiare individuale" (publikuar në gusht 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016.)

2. Aplikimi i standarteve nderkombetare te raportimit financiar te reja dhe te rishikuara (vazhdim)

2.2 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të këtë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

3. Bazat e pergatitjes

3.1 Deklarata e pajtueshmerise

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

3.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike .

3.3 Biznesi ne vijimesi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4 Monedha funksionale

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5 Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

3.6 Bazat e konsolidimit

Filialet janë të gjitha subjektet (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) mbi të cilat Grupi ka fuqi për të qeverisur politikat financiare dhe operative, qe në përgjithësi u atribuohen aksionereve qe zoterojne me shumë se gjysmën e të drejtave të votës. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme janë konsideruar kur eshte bere vleresimi nëse Grupi kontrollon një njësi tjeter ekonomike. Filialet janë konsoliduar plotësisht qe nga data në të cilën kontrolli i eshte transferuar Grupit. Metoda e kostos është përdorur për te kontabilizuar blerjen e filialeve nga Grupi. Kostoja e blerjes është matur ne vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna , instrumentave të kapitalit neto të emetuara dhe detyrimeve të pësuara ose konstatuara në datën e këmbimit, plus kostot direkte te blerjes.

3. Bazat e pergatitjes (vazhdim)

3.6 Bazat e konsolidimit (vazhdim)

Aktivet e identifikueshme të blera dhe detyrimet e konstatuara në një kombinim biznesi njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga interesi i pakicës. Tejkalimi i kostos së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës të grupit të aktiveve neto të identifikueshme njihet si emri i mirë . Transaksionet midis shoqerive te grupit, balancat dhe fitimet e parealizuara për transaksione ndërmjet shoqerive te grupit janë eliminuar. Gjithashtu jane eleminuar humbjet e parealizuara. Politikat kontabël të filialeve janë ndryshuar kur ka qene e nevojshme per t'u perputhur me politikat e miratuara nga Grupi.

4. Politika te rendesishme kontabel

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga shoqëria

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Euro/ LEK	137.28	140.14
USD / LEK	125.79	115.23
GBP / LEK	186.59	179.48
CHF/ LEK	126.74	116.52

4.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.
Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.
Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

4. Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre
Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme
Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë
Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e tregut, dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.
Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së kostos së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skonton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

Vlera e drejtë
Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera
Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar
Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.
Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.
Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4. Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3 Inventari

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.
Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

4. Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

4.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(iii) Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Toka	Nuk amortizohet
Ndërtesa	5%
Mobilje dhe orendi	20%
Mjetet e transportit	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Instalime teknike specifike	20%
Te tjera	20%

Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike që burojnë nga aktivet afatgjata materiale. Prodhimi në proces nuk amortizohet.
Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.
Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5 Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivet afatgjata jo-materiale të blera nga shoqëria paraqiten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (nëse ka) , bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar pas datës së cilës ato janë të gatshme për përdorim. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjata jo-materiale shqyrtohet, në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh në periudhat e ardhshme.

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Programe kompjuterike	Mbi vleren kontabel neto	25%
Licenca	Metoda lineare	15%

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të shoqërisë , përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohen në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston , atëherë vlera e rikuperueshme e aktivit rivlerësohet. Kur vlera kontabël e tejkalon vlerën e rikuperueshme, njihet një humbje nga zhvlerësimi. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

4. Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

4.6 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e vogël se vlera e tij e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron fluksе monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet apo grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme skontohen për ti sjellë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

Në lidhje me aktivet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret në qoftë se ka ndonjë tregues që ky zhvlerësim nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerat e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në masën që vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, në qoftë se asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk është njohur.

4.7 Kosto e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin të aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyre që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjnë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

4.8 Te ardhurat

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme, pavaresisht se kur behet pagesa. E ardhura matet me vlere te drejte te shperblimit te mare per sherbimin e kryer, neto nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe zbritje te mundshme te shitjeve.

4.9 Pagesa e qirase

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

4.10 Provizione

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4. Politika te rendesishme kontabel (vazhdim)

4.11 Perfitimet e punemarresve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit

4.12 Tatim mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi fitimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.
Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 eshte 15% (2014: 15%).

